



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opština Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



01 Nr. 1818
Rahovec, 30.05.2016

Në bazë të nenit 12. Paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 2 dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01Nr 569/1 i datës 16.12.2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2016 , merr këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e planit të mobilitetit të qëndrueshëm për Komunën e Rahovecit

- I. Aprovohet plani i mobilitetit të qëndrueshëm për rregullimin e komunikacionit në territorin e Komunës së Rahovecit.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës dhe drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Rahovecit
- III. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Rahovec, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, nenit 8, të Rregullores së (QRK), Nr-01/2016, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

Me vendim të njoftohen:

1. Zyra e Kryetarit,
2. Shërbimi i Kuvendit
3. Drejtoria për Shërbime Publike, dhe
4. Arkivi

 **REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. i prot. 1818 Më 3-06-2016
Br. prot. Dt. 2016
-III- RAHOVEC - ORAHOVAC



Kryesuesi i Kuvendit

Nahit Elshani